



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM  
Nr. 66, Datë 11.04.2022

**MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SH.P.K., ME NR. 390, SERIA F17, NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 434/1 prot., datë 31.03.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE nr. 250 prot., datë 10.02.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në mbledhjen e bordit të datës 28.02.2022, u relatua relacioni nr. 263/4 prot., datë 21.02.2022, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 390, Seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017”.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 33, datë 28.02.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 390 Seria F17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për arsye të pamjaftueshmërisë së dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria, për fillimin e një procedure, duke konsideruar edhe faktin që kjo është një shoqëri e licencuar edhe më herët dhe njihet me kërkesat e rregullores së licencimit.
- Me shkresën nr. 251/1 prot., datë 02.03.2022, u njoftua shoqëria për vendimin e bordit të ERE-s dhe gjithashtu iu bë me dije se nëse do të paraqesë një aplikim të ri në respektim të kërkesave të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë

*elektrike*”, e ndryshuar, duke respektuar kërkesat e saj për dokumentacionin e kërkuar, atëherë edhe pagesa për aplikim do të konsiderohet e vlefshme për aplikimin e ri.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE nr. 251/2 prot., datë 18.03.2022, ka paraqitur: Plotësim i dokumenteve ligjorë për rinovimin e licencave”, brenda afatit të përcaktuar më sipër dhe si e tillë dokumentacioni i dorëzuar në aplikimin fillestar dhe kryerja e pagesës së aplikimit konsiderohen të vlefshme.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.
- Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë kryesisht dokumentacionin si vijon:
  - Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.
  - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “d”. Plotësuar.
  - Dokumentacionin teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8 , gërmat “a”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h”. Plotësuar.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë),  
**Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:

- gërma “a” (vërtetim për shlyerjen e Tatimit – Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore),  
**Duke qenë se shoqëria rezulton debitore ndaj Tatimit mbi Fitmin dhe Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, do ti kërkohet informacion në lidhje me statusin e procesit të ankimit.**
- gërma “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).  
**Shoqëria duhet të përcjellë në ERE në gjuhën shqipe letrën për shprehje të mbështetjes financiare nga shoqëria mëmë.**

Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.7:

- gërma “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të

njohura me ligj); duhet të dokumentojë se cili është kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi)  
**Shoqëria duhet të përcjellë në ERE në gjuhën shqipe letrën për shprehje të mbështetjes IT nga shoqëria mëmë.**
- **gërma “g”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve).  
**Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.**
- **gërma “I”** (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët.)  
**Shoqëria duhet të depozitojë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores, do të njoftohet shoqëria që ti përcjellë në ERE brenda afateve.**
- Po ashtu shoqëria në zbatim të nenti 11, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar, duhet të përcjellë në ERE të saktësuar objektin e veprimtarisë së tij në QKB, për furnizimin e energjisë elektrike, pasi rezulton e cituar në mënyrë të përgjithshme si shitje e mallrave dhe produkteve të çdo lloji.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në kuadër të rinovimit të licencës së furnizimit të energjisë elektrike duhet të përcjellë në ERE Ekstraktin e saj Historik me veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të shtuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 390 Seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 26.10.2017, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri në datën 26.10.2022.
- Në nenin 16, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj gati 8 (tetë muaj) përpara përfundimit të afatit të parashikuar në nenin 16, pika 2, ndaj si e tillë vlerësohet që në vendimin final të rinovimit të specifikohet data e fillimit të vlefshmërisë së licencës, duke filluar nga data 27.10.2022.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike bazë të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 390 Seria F17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 174, data 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**